



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

PAKR.nr.475/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi – kryetar, Kreshnik Radoniqi dhe Afërdita Bytyqi – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në lëndën penale ndaj të akuzuarit **J.T.** për shkak të veprave penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe të akuzuarve **J.T., R.A.** dhe **M.Sh.** për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë* nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit J.T., avokat S.R., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.209/19 të datës 09.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

1. Me rastin e ankesave të palëve e sipas detyrës zyrtare, **NDRYSHOHET** pjesërisht aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.209/19 i datës 09.11.2020, sa i përket vendimit për konfiskim, ashtu që lirohen sendet e konfiskuara – një jakne me ngjyrë të gjelbër, një duks me ngjyrë të zezë, dhe një telefon celular, të sekuestruara sipas flet-konfiskimeve të policisë numër 2019-CA-1225 dhe 2019-CA-1226 të datës 12.10.2019, dhe këto sende i kthehen të akuzuarit J.T. menjëherë.
2. **REFUZOHEN** si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.T., ndërsa pjesa tjetër e aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.209/19 i datës 09.11.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.209/19 të datës 09.11.2020, të akuzuarin J.T. e ka shpallur fajtor për veprën penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 356 par. 1 të KPRK-së, dhe *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, ashtu që për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, ndërsa për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje 6 (gjashtë) muaj. Me zbatimin e dispozitave të dënimit unik, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 4 (katër) muaj burgim, të cilin do ta mbajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 13.10.2019 deri me datë 14.04.2020 dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 14.04.2020 deri me datë 03.07.2020.

Të akuzuarit J.T. i është konfiskuar një jakne me ngjyrë të gjelbër, një duks me ngjyrë të zezë si dhe telefoni celular.

Të dëmtuarit L.Z., S.Z. dhe V.Z. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Është obliguar i akuzuari J.T. që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 80 (tetëdhjetë) euro, 50 (pesëdhjetë) euro, për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

Me të njëjtin aktgjykim janë liruar nga akuza të akuzuarit J.T., R.A. dhe M.Sh. për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë* nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të akuzuarve R.A. dhe M.Sh. pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i kthehen telefonat celular me numër të rastit 2019-CA-1225 dhe 2019-CA1226. Shpenzimet e procedurës përkitazi me këtë pjesë liruese bien në barrë të mjeteve buxhetore të KGJK-së.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Gjilan për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me shqiptimin e sanksionit penal, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe lënda të kthehet në rivendosje, njëkohësisht sa i përket sanksionit penal, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i rëndë.
- Mbrojtësi i të akuzuarit J.T., avokat S.R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së

ligjit penal, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që të aprovet ankesa, ashtu që aktgjykimi të ndryshohet dhe i akuzuari për veprat penale nga dispozitivi II dhe III i aktakuzës, të kthehet në rivendosje, si dhe të njoftohen për seancën e kolegjit.

- Përgjigje në ankesën e Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit R.A., avokat Kushtrim Isufi, me propozim që të refuzohet ankesa, ndërsa të vërtetohet aktgjykimi.
- Përgjigje në ankesën e Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit M.Sh., avokat Bardhosh Dalipi, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar lidhur me dispozitivin III të aktgjykimit.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.4/21 të datës 06.01.2021, ka propozuar që të aprovet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ashtu që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit J.T. t'i shqiptohet dënim më i lartë, ndërsa sa i përket pjesës liruese aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa të refuzohen ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.T., avokat S.R. dhe përgjigjet në ankesa të mbrojtësve të akuzuarve R.A., avokat Kushtrim Isufi dhe akuzuarit M.Sh., avokat Bardhosh Dalipi, si të pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, në të cilën seancë ka marr pjesë të dëmtuarit L.Z., S.Z. dhe V.Z., i akuzuari J.T. dhe mbrojtësi i tij avokati S.R., i akuzuari R.A. dhe mbrojtësi i tij avokati Kushtrim Isufi dhe i akuzuari M.Sh. dhe mbrojtësi i tij avokati Bardhos Dalipi, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt. Gjatë seancës që të tre të dëmtuarit përkrahën ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse mbrojtësi i të akuzuarit Jeton mbeti pranë pretendimeve të parashtruara me shkrim në ankesë dhe i akuzuari mbështeti pretendimin e mbrojtësit. Gjithashtu edhe mbrojtësit e të akuzuarve Riad dhe Meriton mbeten pranë përgjigjeve në ankesën e Prokurorisë dhe të akuzuarit i mbështetën mbrojtësit e tyre.

Gjykata e Apelit e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par. 1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se **ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet Ankimore

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan

Sipas ankesës së Prokurorisë, aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 383 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 384 par.1 pika 1.7 dhe par.2 të KPPRK-së, sepse dispozitivet e aktgjykimit janë të pakuptueshëm, kundërtshënës me gjendjen faktike dhe me faktet vendimtare që janë paraqitur. Kështu, gjykata e shkallës së parë nuk ka

gjykuar plotësisht lëndën e akuzës si dhe nuk janë marrë parasysh provat si në aktakuzë. Përveç kësaj baze ankimore, pretendohet se aktgjykimi ka zbatim të gabuar të dispozitave të nenit 383 par.1 pika 1.2 lidhur me nenin 385 par.1 pika 1.4 të KPPRK-së, që ka ndikuar që trupi gjykues të tejkalojë kompetencat ligjore. Lidhur me gjendjen faktike, e njëjta është vërtetuar gabimisht, duke marrë parasysh përshkrimin faktik të veprës penale, sepse përkundër deklaratave të dëmtuarve – në cilësi të dëshmitarëve vërtetohet elementi i veprës penale të vjedhjes së rëndë nga ana e të akuzuarve J.T., R.A. dhe M.Sh.. Sa i përket të akuzuarit Jeton dhe dënimit të shqiptuar ndaj tij, sipas prokurorisë është dënim tejet i butë që nuk i përgjigjet intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, shkallës së përgjegjësisë të akuzuarit dhe pasojat e veprave penale. Kështu, rrethanat lehtësuese nuk kanë qenë të asaj rëndësie për një shqiptim të dënimit aq të ulët, ndërkaq rrethanat rënduese nuk është dashur të lihen anash. Andaj, duke marrë parasysh këto pretendime ka propozuar si më lartë.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.T., avokat S.R.

Në ankesën e mbrojtësit pretendohet se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten, sepse nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe ka kundërthënie në mes të arsytimit dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës. Kështu, dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat dhe shkresat e lëndës, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, duke mos vërtetuar ekzaminimin e veshjes – jaknes (lara – lara ose të kamufluar), sipas të cilës rezulton se i dëmtuari L.Z. e ka bërë identifikimin e të akuzuarit Jeton, vetëm mbi bazën e deklaratave të dëshmitarëve, të cilat nuk kanë qenë relevante, duke u dhënë besimin deklaratave të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve L. dhe S.Z.. Lidhur me vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja pretendon se deklaratat e L. dhe S.Z.t, bien ndesh me njëra tjetrën lidhur me identifikimin e të akuzuarit në bazë të jaknes, por edhe distancës në të cili i njëjti ka qenë. Sipas ankesës nuk është provuar se i akuzuari të ketë mbajtur në posedim armën e assesit të ketë shkaktuar ndonjë rrezik. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mungojnë provat në raport me elementet që përbëjnë figurën e veprave penale, ndërsa përgjegjësia e të akuzuarit është bërë vetëm mbi bazën e deklaratave të dëmtuarve, ndërsa mungojnë provat nga instituti i forenzikës dhe dorezës së parafinës, por edhe në mungesë të *corpus deliktit* (armës), me të cilin kishte për tu kryer vepra penale. Andaj, duke pasur parasysh këto pretendime ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPPRK-së, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e lartcekura, si dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPRK-së, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e saj.

Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë e që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, Gjykata e Apelit gjen se nuk janë të bazuara, kjo për shkak se gjykata e shkallës së parë drejt dhe qartë ka arsyetuar se pse provat e administruara vërtetojnë se i akuzuari J.T. ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, si dhe ka arsyetim të mjaftueshëm dhe të drejtë se pse nuk është vërtetuar se të akuzuarit J.T., R.A. dhe M.Sh. nuk kanë kryer veprën penale në bashkëveprim vjedhje e rëndë. Vlerësimin e provave që e ka bërë gjykata e shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë si të drejtë dhe të bazuar në ligj, kjo për faktin se gjykata ka dhënë arsytet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç, duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

Gjetjet lidhur me pjesën dënuese të aktgjykimit të ankimuar

Nga provat e administruara rrjedh se natën kritike të dëmtuarit L.Z. dhe babai i tij S.Z. kanë vërejtur dy persona në oborrin e shtëpisë së V.Z.t, vëllai i S.Z.t, ku ky i fundit i është drejtuar me fjalët “kush jeni ju?”. Menjëherë dy personat kanë filluar të ikin, ndërsa i dëmtuari dhe babai i tij i janë vënë pas. Në ndjekje e sipër, njëri nga dy personat e ka kaluar rrethojën, ndërsa tjetri nuk ka arritur të kalojë dhe ka filluar të shtënat në drejtim të dëmtuarve. Me një moment i dyshimti është rrëzuar dhe i dëmtuari L. i është afruar në afërsi rreth 1.5-2 metra dhe në atë moment i dyshimti ka shtënë duke e goditur me një predhë të dëmtuarin L. në këmbën e majtë nën gju. Kur është afruar i dëmtuari, e ka identifikuar sulmuesin si J.T.i, të cilin e kishte njohur edhe më herët dhe e kishte identifikuar nga fytyra, trupi dhe zëri i tij kur i njëjti i kishte sha në ikje e sipër. Gjithashtu në vendin ku ishte rrëzuar kishte qenë e ndriçuar nga dritat e rrugës dhe e kishte vërejtur se i njëjti kishte të veshur një jakne me lara si të ushtrisë.

Se i akuzuari J.T. ishte personi që ka shtënë me armë është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit L. i cili e ka identifikuar natën kritike dhe se të njëjtin e kishte njohur edhe më parë dhe e kishte pa me xhaketë me lara si të ushtrisë. Gjithashtu, edhe vet i akuzuarit Jeton në deklaratën e tij e kishte pohuar se kishte pas të veshur një xhaketë me lara të ushtrisë, çka korrespondon me deklarin e të dëmtuarit, e po ashtu edhe me rastin e arrestimit i akuzuari e kishte të veshur xhaketën me lara të ushtrisë. Në anën tjetër nuk kishte asnjë të dhënë në shkresat e lëndës se i dëmtuari apo familja e tij, kishin pas ndonjë të keqe apo mosmarrëveshje me të akuzuarin apo familjen e tij. Andaj, deklarimi i të dëmtuarit është i besueshëm lidhur me identifikimin e të akuzuarit dhe vlerësimin e provave nga Gjykata e shkallës së parë lidhur me gjendjen faktike për pjesën dënuese, andaj edhe Gjykata e Apelit gjen se është i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit Jeton se si mund të lirohet për veprën penale të vjedhjes së rëndë, ndërsa të dënohet për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm që konsiderohet se është kryer menjëherë pas vjedhjes, kjo Gjykatë e gjen si të pabazuar për faktin se për veprën penale të vjedhjes nuk ka pas prova mbështetëse që e lidhnin të akuzuarin me vjedhje, por në anën tjetër

dëshmia e të dëmtuarve L. dhe S.Z. janë të mjaftueshme që të vërtetojnë se ishte i akuzuari Jeton që ka shtënë me armë dhe e ka plagosur të dëmtuarin L..

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se nuk mund të ekzistoj vepra penale e armëmbajtjes pa leje për shkak se nuk është gjetur arma, pra mungon *corpus delicti*, kjo Gjykatë gjen se i akuzuari ka shtënë me armë dhe e ka plagosur të dëmtuarin. I dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta në këmbën e majtë nën gju si pasojë e goditjes me predhë të kalibrit 6.35mm, nga arma që ka shtënë i akuzuari. Andaj, në rastin konkret edhe pse nuk është gjetur arma, vet lëndimi i të dëmtuarit me armë nga i akuzuari e vërteton faktin se i akuzuari ka pas armën që rezulton se ka qenë pa leje për shkak se i akuzuari nuk ka prezantuar ndonjë leje si dhe në shkresat e lëndës nuk ka të dhëna se atij i është dhënë ndonjëherë leja për armë. Andaj, edhe ky pretendim është i pabazuar.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë janë të pabazuara. Në ankesë nuk theksohen fakte dhe rrethana të reja të cilat nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por vetëm theksohet se dënimi nuk i përputhet veprave të kryera. Lidhur me vendimin mbi dënim Gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysht rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin, ashtu që si rrethana lehtësuese ka marrë sjelljen e mire të të akuzuarit në gjykatë dhe gjendjen e tij të dobët materiale. Ndërsa si rrethana rënduese ka marrë rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, intensitetin e kryerjes së veprës penale, duke qenë se i njëjti ka shtënë disa herë me armë, deri sa e ka goditur të dëmtuarin me çka tregon vendosmëri për kryerjen e veprës. Gjithashtu edhe mbajtjen në pronësi të armës pa leje paraqet rrezikshmëri në veti, duke qenë se arma si mjet mund të shkakton vepra me pasoja shumë të rënda.

Gjykata e Apelit pajtohet me konstatimet e Gjykatës së shkallës së parë lidhur me rrethanat lehtësuese, ndërsa lidhur me rrethanat rënduese kjo Gjykatë pajtohet pjesërisht. Si rrethanë rënduese Gjykata e Apelit gjen vendosmërinë në kryerjen e veprës penale çka tregon shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur. Por, mbajtja në pronësi të armës nuk mund të merret si rrethanë rënduese, sepse përbën element të veprës penale dhe nuk mund të dyfishohet edhe si rrethanë rënduese.

Megjithatë, Gjykata e Apelit pajtohet me vendimin mbi dënim të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar është në përputhje me peshën e veprave penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Duke i ri-vlerësuar këto rrethana lehtësuese në raport me veprën e kryer, kjo Gjykatë është e bindur se vendimi mbi dënim i shqiptuar sipas këtij aktgjykimit të ankimit, do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Gjetjet lidhur me pjesën liruese të aktgjykimit të ankimuar

Lidhur me pjesën liruese të aktgjykimit të ankimuar me të cilin të akuzuarit J.T., R.A. dhe M.Sh. janë liruar për vepër penale *vjedhje e rëndë* nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Gjykata e Apelit gjen se Gjykata e shkallës së parë me të drejtë konstaton se provat e administruara nuk e vërtetojnë se të njëjtit kanë kryer vjedhjen në shtëpinë e të dëmtuarit V.Z..

Sipas provave të administruara rezulton se gjurmët e gishtërinjve nuk kanë mund të tërhiqen nga vendi i ngjarjes për shkak se kanë qenë të materialit të dobët. Bastisja në shtëpitë e të akuzuarve e kryer me datë 13.10.2010 nuk ka rezultuar me gjetjen e ndonjë sendi të dyshimtë apo që është vjedhur nga i dëmtuari. Po ashtu edhe kontrollimi trupor i të akuzuarve që janë arrestuar natën kritike nuk ka rezultuar me gjetjen e asnjë sendi të vjedhur nga shtëpia e të dëmtuarit. Gjithashtu edhe dëshmitarët dhe të dëmtuarit e rastit – L. Z., S. Z., V. Z. dhe Xh. Z., asnjëri nuk i kishte pa të akuzuarit të kenë kryer vjedhjen, ndërsa dëshmitarja Xh. kishte theksuar se i kishte pa vetëm si hije. Bisedat telefonike në mes të akuzuarve që gjenden në shkresat e lëndës nuk kanë të bëjnë asgjë me vepër penale të vjedhjes apo në çfarëdo konteksti që ndërlihet me këtë vepër penale.

Dyshimi që i akuzuari J.T. ishte njëri nga personat që ka kryer vjedhjen rrjedh nga fakti se i njëjti është identifikuar nga i dëmtuari L. Z. kur kishte shtënë në drejtim tij dhe e kishte plagosur, e të cilin e kishte pa në oborrin e shtëpisë së axhës së tij V. Z.t, është vetëm dyshim i bazuar, por që nuk ka mund të vërtetohet me asnjë provë tjetër, qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë rrethanore. Këtu duhet theksuar se koha e vjedhjes sipas aktakuzës ka qenë rreth orës 19:10, ndërsa koha e plagosjes ka qenë rreth orës 20:00, pra rreth 50 minuta më vonë. I dëmtuari V. Z. kishte deklaruar se në ora 19:10 ishin kthyer në shtëpi me bashkëshorten e tij dhe e kanë vërejtur se i kishin thyer shtëpinë dhe e kanë lajmëruar policin, të cilët pas rreth 10-15 minutave ishin ardhur dhe për deri sa policia kishte qenë në shtëpi ishte dëgjuar e shtëna. Andaj, në këto rrethana dhe mungesën e provave, dyshimet interpretohen në favor të pandehurve, në këtë drejtim aplikohet parimi *in dubio pro reo* dhe me të drejtë të akuzuarit janë liruar nga akuza për vepër penale *vjedhje e rëndë* nga neni 315 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjetjet lidhur me konfiskimin e sendeve

Sa i përket vendimit për konfiskimin e një jakne me ngjyrë të gjelbër, një duks me ngjyrë të zezë, dhe një telefon celular, të sekuestruara sipas flet-konfiskimeve të policisë numër 2019-CA-1225 dhe 2019-CA-1226 të datës 12.10.2019, nga i akuzuari J.T., Gjykata e Apelit gjen se konfiskimi i këtyre sendeve është plotësisht i paarsyeshëm.

Kjo Gjykatë gjen se asnjëra nga sendet e konfiskuara nuk është përdorur në kryerjen e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm dhe se asnjëra nga sendet e lartcekura nuk janë *corpus delicti* në rastin konkret. Gjithashtu, as nga aktakuza e as nga aktgjykimi i ankimuar nuk jepet

asnjë arsyetim se për çfarë arsye duhen të konfiskohen gjësendet e sekuestruara. Aktakuza përveç propozimit për konfiskimin e këtyre sendeve, nuk jep asnjë fjalë të vetme si arsyetim për konfiskimin, si dhe në anën tjetër aktgjykimi i ankimuar, përveç vendimit për konfiskimin e këtyre sendeve, në arsyetim nuk theksohet asnjë fjalë se pse duhet të konfiskohen sendet në fjalë.

Nga këto rrethana, Gjykata e Apelit gjen se nuk ka asnjë bazë ligjore për konfiskimin e këtyre sendeve, andaj edhe është vendosur që këto sende t'i kthehen të akuzuarit J.T..

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 403 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.475/2020 me datë 12.02.2021

Bashkëpunëtori Profesional

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Kreshnik Radoniqi

Xhevdet Abazi

Afërdita Bytyqi